



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës

Nr. 02/185

Datë: 12.06.2018

Mbështetur në nenin 5 pika b, nenin 12 paragrafi 2 pika d, nenin 14 paragrafi 1, nenin 17 pikat: b,e,o,s, nenin 40 paragrafi 2 pika i, të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në bazë të nenit 19 paragrafi 7 pika j, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 të datës:12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e mbajtur me datë: 06.06.2018 mori këtë:

V E N D I M

PËR ZHVENDOSJEN E RRUGËVE EKZISTUESE KADASTRALE NGA BRENDËSIA E
VARREZAVE NË FSHATIN GAJRAK DHE REGJISTRIMI JASHTË RRETHOJËS SË TYRE

1. Miratohet kërkesa Nr.02/64 e datës: 27.03.2018 e parashtruar nga Kryesia e fshatit Gajrak, për zhvendosjen e të gjitha rrugëve të vjetra brenda varrezave dhe zhvendosja-regjistrimi i rrugëve jashtë rrethojave të varrezave në fshatin Gajrak, Zona kadastrale në Marali Komuna e Malishevës.
2. Mbështetur në pikën 1 të këtij vendimi të gjitha rrugët ekzistuese kadastrale që kanë qenë deri me tani brenda varrezave të zhvendosen dhe të bëhet regjistrimi i tyre me numrat faktik të cilat ekzistojnë në Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër, për shkak të krijimit të hapësirës me të madhe brenda tyre, mirëpo e njëjta nuk mund të përdoret për qëllim të pengesave të pjesëve të ngastrave private.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës përmes Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe shërbim Pronëso-ro-Juridik duke zhvendosur, ndarë dhe bashkuar numrat e të gjitha rrugëve dhe parcelave ekzistuese brenda varrezave, dhe regjistrimin e rrugëve jashtë rrethojave të varrezave, të bëhet përkufizimi dhe regjistrimi i tyre gjeodezik me numra kadastral të Komunës së Malishevës si rrugë publike sipas konstatimit të bërë nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe shërbim Pronëso-ro-Juridik.
4. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Shërbim Pronëso-ro-Juridik që të gjitha punët e parapara të cilat janë të specifikuara në konstatim të barten dhe të regjistrohen në librat kadastral të Komunës së Malishevës.
5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 17 të Rregullores nr.01/2017, për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunës, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet:
Arkivit të Komunës
Drejtorive të KK-së
MAPL-së.



Kryesuesi i Kuvendit
Rrahim Morina